REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 tetor 2025
Nr. Ref.:AGJ2832/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI129/25

Parashtrues

Adem Dervishaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së të gjitha procedurave gjyqësore lidhur me lëndën [C.nr.370/19] në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan dhe lëndën [Ca. nr. 1294/2024] në Gjykatën e Apelit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Adem Dervishaj, me vendbanim në Deçan (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [Ca.nr.1294 /2024] në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), ndërlidhur me kohëzgjatjen e procedurës në lëndën [C.nr.370/19] në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [Ca.nr.1294 /2024] në Gjykatën e Apelit, ndërlidhur me kohëzgjatjen e procedurës në lëndën [C.nr.370/19] në Gjykatën Themelore, përmes të cilës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 maj 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës elektronike në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 maj 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr.GJR.KI129/25] caktoi Gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI129/25] kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).

7. Më 19 qershor 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit përkitazi me regjistrimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës, duke i kërkuar që ta njoftojë Gjykatën se: (i) në cilën fazë të procedurës gjendet shqyrtimi i ankesës së parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) çfarë veprimesh janë ndërmarrë lidhur me shqyrtimin e ankesës së tij.

8. Më 20 qershor 2025, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se lënda e parashtruesit të kërkesës është duke u shqyrtuar nga gjyqtari referues.

9. Më 1 tetor 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri: (i) deklaroi kërkesën të pranueshme; (ii) konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të (E drejta për

një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe (iii) ta urdhërojë Gjykatën e Apelit, që jo më larg se më 30 janar 2026, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 26 gusht 2005, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Komunale në Deçan padi kundër (M.D), (N.D), (SH.D) dhe (I.D), përmes të cilës kërkoi shuarjen e të drejtës së servitutit për kalimin me këmbë, qerre tërheqëse dhe automjete në pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr.76, e evidentuar si rrugë private nga fletëposedimi nr.113 KK-Irzniq, pronë e parashtruesit të kërkesës, i cili servitut shtrihet nga mesi i ngastrës kadastrale nr.76 gjer në vijën kufitare të ngastrave nr.74 dhe 73/1. Përmes padisë dhe precizimit të padisë, parashtruesi i kërkesës theksoi se të paditurit nuk i ishin përmbajtur marrëveshjes së arritur në vitin 1990 për shfrytëzim racional dhe mirëmbajtje të rrugës, për të cilën ishin pajtuar që t'iu shërbejë dy familjeve, dhe se servituti ekzistues ishte i panevojshëm pasi të njëjtit kishin qasje në rrugën publike përmes paluajtshmërisë së tyre.

11. Më 24 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Deçan përmes Aktgjykimit [C.nr.206/2005] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, pasi duke u bazuar në nenet 51, 52 dhe 59 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (në tekstin e mëtejmë: LMTHPJ) vlerësoi se nuk ka bazë juridike për shuarjen e servitutit ekzistues sipas marrëveshjes së ndërgjyqësve të arritur para 19 (nëntëmbëdhjetë) vitesh, marrëveshje e cila nuk është kontestuar nga palët brenda afatit ligjor të përcaktuar me rregullat e procedurës civile. Gjykata Komunale në Deçan theksoi se *"[...] në rastin konkret ndërgjyqësit me marrëveshje kanë zgjidhur problemin e servitutit te rrugë kalimit, së këndejmi as sot drejt për drejt nga vendi i ngjarjes, është vërtetuar se nuk ka ndryshuar asnji rrethanë që do të çonte në drejtim të shuarjes së servitutit ekzistues, dhe të paditurit nuk kanë asnji mundësi tjetër rrugë kalimi për tu lidhur me rrugën publike të fshatit."*.

12. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Qarkut) ankesë kundër Aktgjykimit të 24 dhjetorit 2007 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 2 prill 2010, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 84/08] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore. Duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 58 të LMTHPJ-së, që përcakton se pronari i patundshmërisë mund të kërkojë shuarjen e të drejtës së servitutit kur bëhet i panevojshëm për shfrytëzim, Gjykata e Qarkut vlerësoi se nga themelimi i servitutit përmes marrëveshjes së arritur nga ndërgjyqësit nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë që çon në drejtim të shuarjes së tij dhe se rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura përmes ankesës janë të pabazuara.

14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të 2 prillit 2010 të Gjykatës së Qarkut për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, sipas ligjit të zbatueshëm, servituti nuk është themeluar përmes marrëveshjes gojore dhe se të paditurit kanë qasje në rrugën publike pa e shfrytëzuar pjesën e ngastrës së tij me nr.76.

15. Më 7 shkurt 2013, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.212/2010] aprovoi revizionin e parashtruesit të kërkesës dhe lëndën e ktheu për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, pasi vlerësoi se aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët janë të përfshira me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme theksoi se gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, duhet që të vërtetojë faktin se a janë ndryshuar rrethanat pas konstituimit të servitutit, a kanë të padituri mundësi tjetër për qasje në rrugë publike dhe nëse shfrytëzimi i një kalimi të ri shkakton dëm joproporcional.

16. Më 29 maj 2015, Gjykata Themelore, në rigjykim, përmes Aktgjykimit [C.nr.52/2013] aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm për kalimin me këmbë, qerre tërheqëse dhe automjete në pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr.76, dhe obligoi të paditurit që në të ardhmen të mos kalojnë nëpër atë pjesë të ngastrës kadastrale. Gjykata Themelore konstatoi se të paditurit kishin shkaktuar dëme në ngastrën e parashtruesit të kërkesës, të paditurit kanë qasje në rrugë publike pa shfrytëzuar rrugën që kalon nëpër ngastrën e parashtruesit të kërkesës dhe se shfrytëzimi i kalimit të lirë në raport me kalimin nëpër ngastrën e parashtruesit të kërkesës nuk shkakton dëm joproporcional me përjashtim të një muri gjysmë të rrëzuar, i cili nuk shfrytëzohet dhe ka mbetur i shkatërruar. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore, në kuptim të paragrafit 2 të nenit 58 të LMTHPJ-së, aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm.

17. Në një datë të paspecifikuar, të paditurit paraqitën në Gjykatën e Apelit ankesë kundër Aktgjykimit [C.nr.52/2013] të 29 majit 2015 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se përfundimet e arritura nga gjykata e shkallës së parë nuk kanë mbështetje në shkresat e lëndës dhe se të paditurit e kanë fituar të drejtën në bashkëpronësi të sipërfaqes së kontestuar sipas paragrafit 2 të nenit 28 të LMTHPJ-së, pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) vite nga lidhja e marrëveshjes dhe hyrja në posedim si bashkëpronar.

18. Më 25 shtator 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3151/15] aprovoi ankesën e të paditurve, prishi Aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën e ktheu për rigjykim në Gjykatën Themelore. Gjykata e Apelit vlerësoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit theksoi se gjykata e shkallës së parë, në rigjykim duhet që në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të bëjnë thirrjen e të paditurve N.D. dhe SH.D. për seancë gjyqësore apo që përfaqësuesi të dorëzojë autorizimin për përfaqësimin e tyre, të vërtetojë ekzistimin e servitutit sendor dhe bazat për shuarjen e tij duke aplikuar dispozitat e LMTHPJ-së.

19. Më 7 nëntor 2023, Gjykata Themelore, në rigjykim, përmes Aktgjykimit [C.nr.370/2019] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore, mbështetur në nenet 51, 52 dhe 59 të LMTHPJ-së dhe në provat e administruara, siç janë ekspertiza e gjeodetit dhe raporti nga këqyrja e vendit të ngjarjes, arsyetoi se (i) shuarja e servitutit në fjalë u pamundëson të paditurve kalimin e lirë për t'u lidhur në rrugë kryesore pa u dëmtuar muri dhe oborret e tyre në të cilat ka shtëpi banimi; dhe se (ii) nuk ka bazë juridike për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm pasi marrëveshja nuk është kontestuar në afatin prej 1 viti e një muaji sipas rregullave të procedurës civile. Përveç kësaj,

Gjykata Themelore theksoi se veproi në përputhje me udhëzimet e Gjykatës së Apelit pasi të gjithë të padituri ishin përfaqësuar në mënyrë të rregullt nga i autorizuari i tyre dhe se gjendja faktike është vërtetuar edhe përmes ekspertizës dhe plotësim-ekspertizës së gjeodetit të 14 korrikut dhe 10 tetorit 2023 nga dalja në vendin e ngjarjes.

20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Apelit ankesë kundër Aktgjykimit [C.nr.370/2019] të 7 nëntorit 2023 të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se, ndër të tjera, Gjykata Themelore nuk ka respektuar rekomandimet e dhëna përmes aktgjykimeve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, pasi arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është i njëjtë me Aktgjykimin e 24 dhjetorit 2007 të Gjykatës Komunale dhe se gabimisht është zbatuar e drejta materiale kur është konstatuar se nuk është atakuar marrëveshja për krijimin e servitutit.

21. Më 18 dhjetor 2024, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, kërkoi nga Gjykata e Apelit që të vendosë lidhur me ankesën e tij sa më shpejt që është e mundur, marrë parasysh vjetërsinë e lëndës dhe moszgjidhjen e çështjes që ka rezultuar në konflikt që mund të ketë pasoja të rënda.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [Ca.nr.1294 /2024] në Gjykatën e Apelit, ndërlidhur me kohëzgjatjen e procedurës në lëndën [C.nr.370/19] në Gjykatën Themelore, përmes të cilës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

23. Parashtruesi i kërkesës thekson se *"vonesa në veprim dhe procedim të çështjes juridiko kontestimore C.nr.370/19 të Gjykatës Themelore Dega në Deçan e cila është në procedurë ankimore në Gjykatën e Apelit të Kosovës me nr. punues Ca.nr.1294/2024, me vonesë të paarsyeshme ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për liritë dhe të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm […]"*.

24. Më tej, parashtruesi i kërkesës shton se, edhe pas më shumë se 19 (nëntëmbëdhjetë) vitesh në procedurë, lënda gjendet në procedurë në Gjykatën e Apelit pa vendim të formës së prerë dhe se pavarësisht përpjekjeve dhe kërkesave të vazhdueshme për përshpejtimin e procesit, autoritetet gjyqësore nuk kanë siguruar trajtim të drejtë, të shpejtë dhe efikas të kësaj çështjeje.

25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm; (iii) që Republika e Kosovës t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 10.000,00 euro, me kamatë dhe shpenzime në afatin prej 15 ditësh nga marrja e këtij Aktgjykimi; (iv) t'ua kumtojë Aktgjykimin palëve; (v) të

publikojë Aktgjykimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe (vi) të konstatojë që Aktgjykimi hyn në fuqi menjëherë.

Përgjigjja e Gjykatës së Apelit e 20 qershorit 2025

26. Më 20 qershor 2025, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë përgjigje kundrejt shkresës së Gjykatës të 19 qershorit 2025, përmes së cilës i kërkoi informata se në cilën fazë të procedurës gjendet shqyrtimi i ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe se çfarë veprimesh janë ndërmarrë lidhur me shqyrtimin e ankesës së tij.

27. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën si në vijim:

"Referuar kërkesës për informata të parashtruar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e pranuar më 19.06.2025, lidhur me lëndën Ca.nr.1294/24, ju njoftojmë se e njëjta është pranuar më 02.02.2024 në Gjykatën e Apelit.
Lënda me shenjë Ca.nr.1294/24 ndodhet në trajtim nga ana e gjyqtarit referues."

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT [e miratuar më 4 nëntor 1950 nga Këshilli i Evropës]

Neni 6
(E drejta për gjykim të drejtë)

"1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]".

LIGJI MBI MARRËDHËNIET THEMELORE PRONËSORE JURIDIKE
(8 shkurt 1980)

Neni 51

"Servituti real vendoset me veprimin juridik, vendimin e organit shtetëror dhe me anë të parashkrimit fitues."

Neni 52

"Në bazë të veprimit juridik servituti real fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj."

Neni 58

"Servituti real pushon në qoftë se pronari i pronës shërbyese kundërshton ushtrimin e tij, kurse pronari i pronës sunduese tre vjet rresht nuk e ka ushtruar të drejtën e vet.

Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që të pushojë e drejta e servitutit real kur ai bëhet i panevojshëm për shfrytëzimin e pronës sunduese ose kur nuk ekziston më arsyeja për të cilën ai është vendosur.

Servituti real pushon po qe se nuk ushtrohet gjatë kohës së nevojshme për fitimin e tij me anë të parashkrimit fitues, kur i njëjti person bëhet pronar i pronës shërbyese dhe i pronës sunduese ose me shkatërrimin e pronës sunduese, respektivisht të pronës shërbyese."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Nenit 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

30. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç janë të parashikuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa Individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashohin:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".

31. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe se i njëjti ka saktësuar kërkesën e tij ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C.nr.370/19] në Gjykatën Themelore ndërlidhur me gjykimin e lëndës [Ca.nr.1294 /2024] në Gjykatën e Apelit, e cila ende nuk ka përfunduar pranë kësaj të fundit. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë dy instancave të lartcekura gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajve.

32. Gjykata gjithashtu thekson se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës, prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

33. Gjykata rikujton se esenca e rastit ndërlidhet me padinë e parashtruesit të kërkesës të 26 gushtit 2005, të paraqitur kundër M.D., N.D., SH.D. dhe I.D., përmes të cilës kërkoi shuarjen e të drejtës së servitutit për kalimin me këmbë, qerre tërheqëse dhe automjete në pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr.76, pronë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit të 24 dhjetorit 2007, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës pasi vlerësoi se sipas LMTHPJ-së nuk ka bazë juridike për shuarjen e servitutit ekzistues sipas marrëveshjes së ndërgjyqësve, marrëveshje e cila nuk është kontestuar nga palët brenda afatit ligjor të përcaktuar me rregullat e procedurës civile, aktgjykim i cili u vërtetua nga Gjykata e Qarkut. Pas dorëzimit të revizionit nga ana e

parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme përmes aktvendimit lëndën e ktheu për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, pasi vlerësoi se aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët janë të përfshira me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Më 29 maj 2015, Gjykata Themelore, në rigjykim, përmes Aktgjykimit aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm dhe obligoi të paditurit që në të ardhmen të mos kalojnë nëpër atë pjesë të ngastrës kadastrale, pasi konstatoi se të paditurit kanë shkaktuar dëme në ngastrën e parashtruesit të kërkesës, të paditurit kanë qasje në rrugë publike pa shfrytëzuar rrugën që kalon nëpër ngastrën e parashtruesit të kërkesës dhe se shfrytëzimi i kalimit të lirë në raport me kalimin nëpër ngastrën e parashtruesit të kërkesës nuk shkakton dëm joproporcional. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u prish nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të 25 shtatorit 2019, dhe lënda u kthye për rigjykim në Gjykatën Themelore.

34. Më 7 nëntor 2023, Gjykata Themelore, në rigjykim, përmes Aktgjykimit refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar se pas administrimit të provave vërtetohej se (i) shuarja e servitutit u pamundëson të paditurve kalimin e lirë për t'u lidhur në rrugë kryesore pa u dëmtuar muri dhe oborret e tyre në të cilat ka shtëpi banimi; dhe se (ii) nuk ka bazë juridike për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm, pasi marrëveshja nuk është kontestuar në afatin prej 1 viti e një muaji sipas rregullave të procedurës civile. Kundër këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Apelit ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

35. Në kërkesën e tij para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës specifikon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si rezultat i kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [Ca.nr.1294 /2024] në Gjykatën e Apelit.

36. Gjykata në vijim do të shqyrtojë pretendimin e parashtruesit për tejzgjatje të procedurës së zhvilluar dhe do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në të cilin rast Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Përkitazi me pretendimin lidhur me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore

37. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]"*.

38. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se *"Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]"*.

39. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

A. Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedurës

40. Gjykata rikujton se përllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje, me kërkesë të palëve, për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar. Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih, rastin e Gjykatës, KI183/21, parashtrues *NNT Sokoli,* Aktgjykim, i 30 marsit 2022, paragrafi 74, shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *Konig kundër Gjermanisë*, nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 98 dhe *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50).

B. Parimet e përgjithshme të kohëzgjatjes së procedurës

41. Gjykata rikujton se është detyrim i shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së *Comingersoll kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 24; *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 142).

42. Gjykata rikujton se administrimi i drejtësisë pa vonesa është shumë i rëndësishëm për të mos e rrezikuar efikasitetin dhe kredibilitetin e sistemit të drejtësisë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Scordino kundër Italisë* (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafët 224-225). Zgjatja e tepruar e administrimit të drejtësisë përbën një nga rreziqet kryesore kundër sundimit të ligjit. Kur shkeljet në lidhje me zgjatjen e procedurave gjyqësore bëhen të shpeshta dhe nuk janë raste të izoluara, atëherë akumulimi i këtyre shkeljeve përbën një praktikë e cila nuk është në përputhje me KEDNJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së *Bottazzi kundër Italisë*, nr. 34884/97, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 22).

Kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

43. Arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse të secilit rast (shih, rastin e GJEDNJ-së *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43). Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) ndërlikueshmërinë e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

a) Ndërlikueshmëria e rastit

44. Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka vënë në dukje që kompleksiteti i rastit mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen (shih, rastin e Gjykatës, KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim, i 12 shkurtit 2025, paragrafi 49, shih, rastet e GJEDNJ-së *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit

1999, paragrafi 63; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 210).

45. Edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, rastin e GJEDNJ-së *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

b) Sjellja e palës

46. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të afirmuar edhe nga vetë Gjykata, neni 6 i KEDNJ-se, respektivisht neni 31 i Kushtetutës, nuk kërkon nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 68; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211; shih, rastin e Gjykatës KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 50).

47. Nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave procedurale, dhe të mos përdor taktika për të shtyrë në favor të tij procedurën (shih, rastin e GJEDNJ-së *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i mëveshët autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e GJEDNJ-së *Wiesinger kundër Austrisë*, nr. 11796/85, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 57). Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Humen kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 66).

48. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës: mungesa e vullnetit të palës për të dorëzuar shkresat mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës para gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave procedurale (shih, rastet e GJEDNJ-së *Vernillo kundër Francës*, nr. 11889/85, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 34; *Konig kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 103; *Pizzetti kundër Italisë*, nr. 12444/86, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 18; *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33; dhe *Keaney kundër Irlandës*, nr. 72060/17, Aktgjykim i 30 prillit 2020, paragrafi 95).

c) Sjellja e autoriteteve shtetërore

49. Shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet: jo vetëm për sistemin gjyqësor, por për të gjitha institucionet publike (shih, rastin e GJEDNJ-së *Martins Moreira kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 60). Gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata duhet të vlerësojë procedurën në tërësi: përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211; shih rastin e Gjykatës KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023, paragrafët 71-73).

50. Shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve, nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme (shih, rastin e GJEDNJ-së *Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, nr. 9316/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 58). Mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave (shih, rastin e GJEDNJ-së *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, Aktgjykim i 1 korrikut 1997, paragrafi 64). Vonesat e shkaktuara nga reformat që synojnë të përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve, nuk mund po ashtu të shërbejnë si arsyetim për tejzgjatje të procedurës, për shkak se është përgjegjësi dhe detyrë e shtetit të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë që të shmang tejzgjatjen e procedurave në rastet e mbetura pa u zgjidhur (shih, rastin e GJEDNJ-së *Fisanotti kundër Italisë*, nr. 32305/96, Aktgjykim i 23 prillit 1998, paragrafi 22).

51. Gjykata në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat e tejzgjatura të mos shkaktojnë pasiguri tek palët. Gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj rendit juridik do të rrezikohej (shih, rastin e Gjykatës KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 67).

d) Rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest

52. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë rastet që ndërlidhen me statusin civil (shih, rastin *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 44); rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve (shih, rastin, *Q dhe R kundër Sllovenisë*, nr. 19938/20, Aktgjykim i 8 shkurtit 2022, paragrafi 80; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës (shih, rastin *Sartory kundër Francës*, nr. 40589/07, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009); ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "sëmundje të pashërueshme" dhe kanë "pritje të reduktuar të jetëgjatësisë" (shih, rastin *A dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996, paragrafët 78-81); rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, ndër tjerash rastet *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 213; *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 22 prillit 2021, paragrafi 63-64) .

C. Aplikimi i parimeve në rrethanat e rastit konkret

(i) Periudha që do të merret parasysh

53. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ka vlerësuar se përllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar.

54. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës, më 26 gusht 2005, dorëzoi në Gjykatën Komunale në Deçan padi kundër M.D, N.D, SH.D. dhe I.D., për shuarjen e të drejtës së servitutit për kalimin me këmbë, qerre tërheqëse dhe automjete në pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr. 76, e evidentuar si rrugë private nga fletëposedimi nr. 113 KK-Irzniq, pronë e parashtruesit të kërkesës. Nga shkresat e lëndës rezulton se rasti i parashtruesit të kërkesës është kthyer 2 (dy) herë në rivendosje tek Gjykata Themelore, përkatësisht përmes Aktvendimit [Rev. nr. 212/2010] të 7 shkurtit 2013 të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimit [Ac. nr. 3151/15] të 25 shtatorit 2019 të Gjykatës së Apelit.

55. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, llogaritet nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatën Komunale, më 26 gusht 2005, dhe e njëjta ka vazhduar të shqyrtohet pranë Gjykatës Themelore edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi dhe më pas në Gjykatën e Apelit, ku në këtë të fundit ka qenë ende duke u shqyrtuar deri më 13 maj 2025, ditën kur parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë. Rrjedhimisht, kjo është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata.

*(ii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedur*ës

56. Ashtu siç është elaboruar edhe më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën gjyqësore përmes padisë së dorëzuar në Gjykatën Komunale për shuarje të së drejtës së servitutit për kalim në pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr. 76, e evidentuar si rrugë private nga fletëposedimi nr.113 KK-Irzniq, pronë e parashtruesit të kërkesës.

57. Në vijim të kësaj, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës së zhvilluar gjyqësore në tërësinë e saj ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të marrë parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtruesit të kërkesës; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

a) Ndërlikueshmëria e rastit

58. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ky rast është i lidhur me kërkesën e tij për shuarjen e të drejtës së servitutit dhe se në rrethanat e këtij rasti janë përfshirë disa të paditur, se është nxjerrë një ekspertizë dhe plotësim i ekspertizës nga eksperti i gjeodezisë për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe pas kthimit të lëndës në rigjykim për herë të dytë, janë ftuar të paditurit N.D. dhe SH.D. për seancë gjyqësore, duke ndikuar kështu në ndërlikueshmërinë e procedurës.

b) Sjellja e parashtruesit të kërkesës

59. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesave në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat proceduralë të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave duhet të kenë parasysh, gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ-së *McFarlane kundër Irlandës*, nr. 31333/06, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafin 148; *Eckle kundër Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

60. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, siç janë ankesa dhe revizioni, për t'i atakuar vendimet e gjykatave të rregullta. Lidhur me veprimet procedurale të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së ku kishte sqaruar se parashtruesve të kërkesës u kërkohet të tregojnë kujdes në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe për t'u përmbajtur nga përdorimi i taktikave të vonimit të shqyrtimit të rastit të tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 17766/19, Aktgjykim i 12 tetorit 2021, paragrafi 91, ku GJEDNJ-ja kishte konstatuar se bazuar në sjelljen e ankuesit nuk ka tregues se ai ka shkaktuar apo kontribuar në zvarritje të procedurave).

61. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata e Apelit lishte kërkuar që kjo e fundit të vendosë lidhur me ankesën e tij sa më shpejt që është e mundur, duke marrë parasysh vjetërsinë e lëndës dhe moszgjidhjen e çështjes që ka rezultuar në një konflikt që mund të ketë pasoja të rënda.

62. Prandaj, Gjykata, duke u bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, që nga data e parashtrimit të padisë, konsideron se veprimet e parashtruesit të kërkesës nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e gjykatave të rregullta, respektivisht në shqyrtimin e rastit të tij.

c) Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore

63. Gjykata vëren se në rastin konkret, pas refuzimit të padisë së parashtruesit të kërkesës për shuarjen e të drejtës së servitutit nga Gjykata Komunale në Deçan, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut, ku kjo e fundit refuzoi ankesën dhe vërtetoi Aktgjykimin e ankimuar. Më pas, pas paraqitjes së revizionit nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme, kjo e fundit kishte aprovuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, duke e kthyer lëndën në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë. Gjykata Themelore, në rigjykim, aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm dhe obligoi të paditurit që në të ardhmen të mos kalojnë nëpër atë pjesë të ngastrës kadastrale. Pas ankesës së të paditurve, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u prish nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të 25 shtatorit 2019, dhe lënda u kthye sërish për rigjykim në Gjykatën Themelore. Më 7 nëntor 2023, Gjykata Themelore, në rigjykim, refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës pasi vlerësoi se shuarja e servitutit u pamundëson të paditurve kalimin e lirë për t'u lidhur në rrugë kryesore dhe se nuk ka bazë juridike për shuarjen e të drejtës së servitutit të përhershëm. Kundër këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Apelit ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave

të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale

64. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se në çështjen respektive, për vërtetimin e saktë të gjendjes faktike, vetëm në lëmin e gjeodezisë janë bërë gjithsej 3 (tri) ekspertiza dhe 1 (një) plotësim i ekspertizës, përkatësisht (i) ekspertiza e 20 marsit 2007; (ii) ekspertiza e 13 shtatorit 2013 (pas kthimit në rivendosje të lëndës nga Gjykata Supreme); dhe (iii) ekspertiza e 31 marsit 2023 dhe plotësim ekspertiza e 10 tetorit 2023 (pas kthimit në rivendosje të lëndës nga Gjykata e Apelit).

65. Po ashtu, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të 25 shtatorit 2019, theksoi se gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, duhet që, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të bëjnë thirrjen e të paditurve N.D. dhe SH.D. për seancë gjyqësore apo që përfaqësuesi të dorëzojë autorizimin për përfaqësimin e tyre.

66. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se çështja e parashtruesit të kërkesës është në procedurë gjyqësore që nga viti 2005, gjegjësisht për më tepër se 19 (nëntëmbëdhjetë) vite, dhe se lënda është kthyer në rigjykim tek gjykata e shkallës së parë 2 (dy) herë. Nga shkresat e lëndës rezulton se nga kthimi i lëndës në rigjykim për herë të parë nga Gjykata Supreme, gjykata e shkallës së parë ka vendosur për padinë e parashtruesit të kërkesës pas më shumë se 2 (dy) vitesh, ndërkaq që herën e dytë, përkatësisht pas kthimit në rivendosje nga Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës pas 4 (katër) vitesh. Thënë këtë, Gjykata pavarësisht faktit që gjatë periudhës së shqyrtimit të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës janë nxjerrë vendime dhe para gjykatave të rregullta janë mbajtur seanca, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e procedurës së zhvilluar gjyqësore në tërësinë e saj është e paarsyeshme.

67. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se ndikim në kohëzgjatjen e procedurave kanë pasur dorëzimi i raporteve të ekspertizave të gjeodezisë në Gjykatën Themelore, që rezultuan si rrjedhojë e konstatimit të Gjykatës së Apelit që gjendja faktike nuk ishte vërtetuar drejtë nga Gjykata Themelore, dhe vonesën në thirrjen e të paditurve N.D. dhe SH.D. për seancë gjyqësore. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra dhe se periudha kohore prej më shumë se 19 (nëntëmbëdhjetë) vitesh në pritje të zgjidhjes së lëndës civile në fjalë i atribuohet organeve gjyqësore.

d) Rëndësia e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest

68. Lidhur me kriterin e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest, Gjykata sqaroi se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga *"sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë"*, si dhe rastet rreth të drejtës për arsim.

69. Rrjedhimisht, Gjykata, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson që padia e parashtruesit të kërkesës për shuarje të së drejtës së servitutit nuk është çështje që kërkon "kujdes të posaçëm" siç janë shembujt e lartcekur të vlerësuara nga GJEDNJ si kategori e çështjeve që kërkojnë zgjidhje e prioritet.

D. Përfundim lidhur me kohëzgjatjen e procedurave

70. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se: (i) rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest civilo-juridik që ka për objekt shuarjen e të drejtës së servitutit, dhe si e tillë çështja rezulton të jetë relativisht e ndërlikuar për t'i dhënë epilog; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, dhe (iii) për më tepër se 19 (nëntëmbëdhjetë) vite, çështja e tij nuk është ka zgjidhur ende dhe rrjedhimisht kjo vonesë është e pajustifikueshme.

71. Thënë këtë, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, ka shkelje të së drejtës së tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

72. Marrë për bazë konstatimin e Gjykatës që në rastin e parashtruesit të kërkesës procedura e zhvilluar gjyqësore në tërësinë e saj ka rezultuar në shkelje të së drejtës së tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, si dhe marrë parasysh faktin që deri në këtë datë, procedura e shqyrtimit të ankesës është ende duke u zhvilluar para Gjykatës së Apelit, Gjykata vlerëson se me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mëtejshme në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, Gjykata e Apelit duhet që, më përshpejtim të përfundojë procedurën e shqyrtimit gjyqësor të ankesës.

E. Përkitazi me kërkesën për kompensim

73. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensoj atij shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro *"me kamatë dhe shpenzime në afatin prej 15 ditësh nga marrja e këtij Aktgjykimi"*. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNj-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet e Gjykatës KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, pargrfai 68, KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, cituar më lart, paragrafi 104).

74. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të *"shpërblimit të drejtë",* sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësoj një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 69; dhe KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 1 tetor 2025, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit, që jo më larg se 30 janar 2026, të informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit ta publikojë në Gazetën Zyrtare;

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban Nexhmi Rexhepi